



Datë: 06.02.2026

Numër Protokolli: 672/2026

A.nr.2071/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.2071/2025, të datës 26.12.2025, të parashtruar nga ankuesja G.B, nga Gjilani, kundër organit të punësimit, Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 06.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.2071/2025, e datës 26.12.2025, e parashtruar nga ankuesja G.B.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me numër protokolli 02-016/01, i datës 15.12.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore, për rezultatet përfundimtare në konkursin me Reference: RN00017761 për pozitën “Zyrtar për Zhvillim Socio Ekonomik”.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, G.B (*tutje referuar: Ankuesja*), me datë 26.12.2025, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit sipas konkursit me Nr. Reference RN00017761, për Grupin e Shkencave Shoqërore, pozita Zyrtar për Zhvillim Socio Ekonomik i shpallur nga Komuna e Gjilanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 31.12.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjilanit, ndërsa kjo e fundit më datë 16.01.2026 dhe datë 29.01.2026, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 8076/2025 të datës 26.12.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 15.12.2025 të kandidatit të suksesshëm; Vendimin e Këshillit A.nr.1489/2025 të datës 29.10.2025; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 31.12.2025; Përgjigje në ankesë e datës 16.01.2026; Vendimin e datës 18.12.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Njoftimin e datës 08.12.2025; Njoftimin e datës 24.11.2025; Vendimin e datës 03.12.2025 të Kryetarit të Komunës me shkresat përcjellëse; Ankesën me numër protokolli 5103/2025 të datës 28.07.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankueses; Vërtetimin e datës 11.12.2024; Raportin e punës 2023; Njoftimin për kandidatin fitues datës 08.07.2025; Konkursin me Nr. Reference RN00017761, për Grupin e Shkencave Shoqërore, pozita Zyrtar për Zhvillim Socio Ekonomik; Listën e kandidatëve që kanë kaluar testin me shkrim datës 04.07.2025; Raportin e punës për vitin 2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.08.2025, 08.09.2025 dhe 23.09.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 03.10.2025; Shkresën e datës 09.01.2025 për aprovimin dhe konfirmimin e Qëndrueshmërisë Buxhetore; Vendimin me numër protokolli 02/874 të datës 26.06.2025 për formimin e Komisionit të Pranimit dhe Akt Emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit; Listën e aplikantëve; Listën nga SIMBNJ për vlerësim të intervistës me gojë; Aplikacionin e ankueses i datës 05.05.2025 me dokumentacionin nga faqe 1-18; Aplikacionin e kandidates fituese i datës 28.05.2025 me dokumentacionin nga faqe 1-14; Vendimin me numër protokolli 6048/2025 të datës 09.09.2025 për vazhdimin e afatit për vendosje të ankesës së ankueses; E-mail i datës 29.01.2026 dërguar nga F.H për Këshillin; Shkresë e SIMBNJ-së për llogarinë e trustit; testin e ankueses si dhe kandidates së suksesshme.

Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë, të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses ***është e pabazuar, sepse:***

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Komuna e Gjilanit, me datë 02.05.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017761, me emrin e Grupi i Shkencave Shoqërore, gjegjësisht për pozitën e punës “Zyrtar për Zhvillim Socio Ekonomik”, në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, klasa profesional 2, me afat aplikimi nga data 03.05.2025 deri më datë 01.06.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 45 kandidatë, ndërsa fazën e verifikimit paraprak e kanë kaluar 30 kandidatë mesin e tyre edhe ankuesja. Sipas njoftimit të datës 04.07.2025 testin me shkrim e ka kaluar vetëm një kandidatë. Pas përfundimit të procedurës, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, më datë 08.07.2025, ka publikuar njoftimin me numër protokolli 02-016-56374 për rezultatet përfundimtare, me kandidaten fituese B.A me 90.6 pikë, kurse ankuesja, me datë 28.07.2025 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin se kandidatja fituese nuk ka përvojë punë në fushën relevante, duke ngre dyshime për shkelje ligjore në këtë procedurë. Kërkon që të shqyrtohet tërësisht procedura, të pezullohet vendimi për emërimin e kandidates fituese dhe të bëhet një rivlerësim nga një komision i ri dhe i pavarur.

Fillimisht, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses si dhe konstatimit të gjendjes faktike përmes provave të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, në procedurë administrative

me datë 28.10.2025 përmes Vendimit A.nr.1489/2025 dhe numër protokolli:7036/2025, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankueses, duke e anuluar Njoftimin e datës 08.07.2025 për kandidaten fituese, pasi që ishte konstatuar fakti se kandidatja fituese nuk e kishte plotësuar kriterin e konkursit që ndërlidhet me përvojën e punës, respektivisht e njëjta përvojën e punës të deklaruar ne sektorin privat nuk e ka dëshmuar me dëshmi shtesë, respektivisht me pasqyrën e llogarisë së trustit, si dhe kishte konstatuar se Komisioni i Pranimit ishte i themeluar në kundërshtim me ligjin material, kurse procedura e rekrutimit ishte kthyer në fazën e verifikimit paraprak.

Kryetari i Komunës së Gjilanit me qëllim të zbatimit të vendimit të Këshillit, me datë 20.11.2025 kishte nxjerrë Vendimin Nr.3210, duke e detyruar Njësinë e Burimeve Njerëzore që të rifillojë procedurën nga faza e verifikimit paraprak, me qëllim të shqyrtimit të aplikacioneve të kandidatëve, ashtu që pas kësaj faze rezulton që kandidatja B.A përsëri e ka kaluar fazën e verifikimit parak, sikurse këtë fazë e kishte kaluar edhe ankuesja ndërsa pasi që të dyja i janë nënshtruar testimit me shkrim, ndërsa ankuesja në testin me shkrim të datës 03.12.2025 ka arritur gjithsejtë 26 pikë të cilat nuk ka qenë të mjaftueshme për të kaluar testin me shkrim nga 50 pikë sa është e nevojshme për të vazhduar në procedurën e rekrutimit, respektivisht intervistës me gojë, sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara nga Rregullorja (QRK) Nr.15/2023 Për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, neni 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: ‘2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë’, kurse kandidatja B.A në testin me shkrim të datës 03.12.2025 ka arritur 70 pikë, e që sipas Njoftimit të datës 15.12.2025 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, i plotësuar sipas Vendimit të datës 18.12.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore, pas kryerje së intervistimit me gojë, rezulton se kandidatja në fjalë ka marrë gjithsejtë 100 pikë, dhe rezulton të jetë edhe kandidatja e suksesshme në procedurën përkatëse të rekrutimit.

Ankuesja, sërish ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Komuna e Gjilanit nuk ka zbatua vendimin e Këshillit ngase konkursi është dashur të kthehet në pikën zero, pasi që sërish rezulton që kandidatja fituese të jetë e njëjta për të cilin ishte konstatuar se nuk i ka plotësuar kushtet e konkursit ngase nuk ka përvojë punë sikurse vlerësimi nuk ka qenë objektiv, duke ngre dyshime për shkelje ligjore në këtë procedurë, dhe kërkon që të shqyrtohet tërësisht procedura, të anulohet vendimi për emërimin e kandidatit fitues dhe të anulohet konkursi në tersi.

Kolegji i Këshillit fillimisht thekson faktin se nuk është i qëndrueshëm pretendimi ankimor i ankueses se Këshilli përmes Vendimit A.nr.1489/2025 të datës 28.10.2025, respektivisht Këshilli përmes aktit në fjalë e kishte anuluar Njoftimin për kandidatin e suksesshëm, ndërsa procedurën e rekrutimit e kishte kthyer ne fazën e verifikimit paraprak, për shkak se nga shkresat e lëndës të dërguara fillimisht nga organi i punësimit rezulton se ankuesja nuk e kishte mbështetur aplikacionin e saj edhe me pasqyrën e llogarisë së trustit, sikurse edhe Komisioni i Pranimit ishte themeluar në kundërshtim me ligjin material për arsyet e dhëna si në arsyetimin vendimit të Këshillit i cekur si më lartë, prandaj ky pretendim i ankueses nuk është i bazuar, pasi që konkursi në fjalë nuk është anuluar në tersi pasi që ishte konstatuar se i njëjti kishte qenë i shpallur në pajtim me ligjin material.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e konkursit me Nr. Reference: RN00017761 për Grupi i Shkencave Shoqërore, gjegjësisht për pozitën e punës “Zyrtar për Zhvillim Socio Ekonomik”, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), Juridike, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike.* **Kërkesat Specifike:** *Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacion në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase.* **Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Rrjedhimisht, Kolegji me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, **përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;** dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj”, si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *2.Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendimit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. **kopjet e dëshmisë së punësimit;** 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.**

Nëse i referohemi pikës 5 të konkursit tek dokumentet që duhet dorëzohen si pjesë e aplikimit kërkohet: *Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës; Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës, Nëse diploma është e fituar jashtë vendimit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmo se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; Kopjen e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Përvoja e punës e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtetet tjetër dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës; Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit; Kopjen e dokumenteve tjetra që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuar në shpalljen e rekrutimit dhe të deklarata në aplikacion.*

Bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës, Kolegji ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses, respektivisht ka shqyrtuar aplikacionin e kandidates fituese të datës 28.05.2025, e sipas të cilës rezulton se e njëjta posedon Diplomën me Nr.13550 të datës 15.07.2024 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshmohej se më datë 26.03.2013 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Ekonomik duke marr titullin Ekonomiks BSC, ndërsa lidhur me përvojën e punës sipas Vërtetimit për Praktikën e kryer të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme me datës 16.02.2012 ka kryer praktikën para diplomimit në këtë institucion prej datës 16.01.2012 deri më datë 16.02.2012, sipas Vërtetimit të datës 26.07.2024 të lëshuar nga Danushi Com Sh.p.k e njëjta ka qenë në marrëdhënie punë nga data 01.04.2021 deri më datë 31.05.2024, sipas aneks kontratës për punë dhe detyra specifike Nr. 01-696/19, të datës 01.02.2019 të lëshuar nga kompania publike VALA e njëjta nga data 01.06.2019 deri më datë 28.09.2019 ka punuar si Zyrtar i Shitjes, sipas Rekomandimit nga ALBIMI LTD të datës 15.07.2024 e njëjta nga data 15.08.2015 e deri më datë 31.01.2019 ka qenë Menaxhere e Shitjes, sipas Referencës së datës 31.07.2024 të lëshuar nga N.T.P “Thes -Ari” e njëjta nga prilli 2013 deri në fillim të gushtit 2014 ka qenë e punësuar në këtë kompani.

Lidhur me përvojën e punës e cila sipas vendimmarrjes së Këshillit përmes Vendimit A.nr.1489/202, ishte konstatuar se ankuesja nuk e ka mbështetur aplikacionin e saj me pasqyrën e llogarisë së Trustit lidhur me përvojën e punës të deklaruar në sektorin privat, Kolegji i këshillit me rastin e rishqyrtimit të lëndës në këtë procedurë administrative të iniciuar përmes ankesës së datës 26.12.2025 nën shifrën A.nr.2071/2025, thekson faktin se Komuna e Gjilanit me rastin e dërgimit të dokumentacionit përkatës të lëndës, nuk e kishte dërguar pasqyrën e llogarisë së Trustit, të cilën sistemi i integruar i SIMBNJ-së e gjeneron, ashtu që lidhur me rastin përkatës Kolegji i Këshillit pas analizimit të sistemit përkatës ka ardhur në përfundimin se kandidatët në procedurë, me rastin e aplikimit ata mundën por nuk janë të obliguar të ngarkojnë në formë manuale edhe pasqyrën e llogarisë së trustit, ngase tanimë sistemi i SIMBNJ-së, në procedurat e rekrutimit është i lidhur me sistemin online të Trustit të Kosovës, ashtu që për secilin kandidat në procedurë rekrutimi në mënyrë automatike e gjeneron gjendjen e llogarisë së trustit, siç kishte ndodhur me kandidaten e suksesshme B.A, mirëpo Komuna e Gjilanit fillimisht nuk e ka dërguar këtë shkresë, ashtu që përmes shkresës së datës 29.01.2026 ishte dërguar pasqyra të cilën e gjeneron sistemi automatik i SIMBNJ-së nga Trusti i Kosovës, ashtu që Kolegji i Këshillit ia fali besimin kësaj prove dhe konstatoi se përvoja e punës sipas vërtetimeve/rekomandimeve apo referencave të së njëjtës, mbështetet edhe në provën e dërguar sipas pasqyrës e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale, të cilën sistemi i SIMBNJ-së e gjeneron në mënyrë automatike sipas numrit personal, andaj nisur nga konstatimet e dhëna si më sipër Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidatja e suksesshme i ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të konkursit ndërlidhur me përvojën e punës, ndërsa lidhur me vendimmarrjen sipas Vendimit A.nr.1489/2025 të datës 28.10.2025, mbetet në përgjegjësi të organit që ka zhvilluar procedurën e rekrutimit, pasi që nuk e ka dërguar me kohë provën përkatëse që dëshmon një gjë të tillë, ndërsa organi vendimmarrës në rrethanat e rastit në fjalë, Këshilli ka vendos vetëm mbi bazën e provave të ofruara nga palët në procedurë.

Po ashtu, në ri procedurë sipas Vendimit të Këshillit, Komuna e Gjilanit e ka themeluar përsëri apo e ka ndryshuar Komisionin e Pranimit sipas vërejtjeve të dhëna të Këshillit, ashtu që përmes Vendimit nr.3224 të datës 03.12.2025 Kryetari i Komunës së Gjilanit e ka themeluar Komisionin e Pranimit në përbërje si në vijim: B.K-kryesues i cili sipas akt emërimit të datës 06.01.2024 mban pozitën e punës “Udhëheqës i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore”; F.O-anëtarë i cili sipas vendimit nr.3212 të datës 25.11.2026 të Kryetarit të Komunës është i emëruar në pozitën “Ushtues Detyre i Udhëheqësit të Zyrës së Projekteve”; F.K-anëtarë i cili sipas vendimit nr.3213 të datës 25.11.2026 të Kryetarit të Komunës është i emëruar në pozitën “Ushtues Detyre i Udhëheqësit për Buxhet dhe Financa”; J.J-anëtarë i cili sipas vendimit nr.1237 të datës 04.09.2026 të Kryetarit të Komunës është i emëruar në pozitën “Ushtues Detyre i Udhëheqësit të Sektorit të Arsimit”, si dhe Sh.L-anëtarë i cili sipas akt emërimit të datës 20.01.2025 mban pozitën e punës “Zyrtar për tatimin në pronë”, ashtu që pas konstatimit të dhënë si më lartë, Kolegji i Këshillit konstatoi se në rrethanat e rastit përkatës, Komisioni i Pranimit i ri themeluar sipas Vendimit nr.3224 të datës 03.12.2025, është në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuar nga neni 40 paragrafi 2 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale.”*

Fillimisht Kolegji i Këshillit, nga analizimi i testit me shkrim të ankueses konstatoi se e njëjta nga testi me shkrim kishte arritur të grumbullonte gjithsejtë 26 pikë (prej të cilave 26 pike nga pyetjet me përgjigje opsionale, kurse 0 pikë nga eseja), ndërsa kandidatja e suksesshme nga testi me shkrim kishte arritur të grumbullonte gjithsejtë 70 pikë (prej të cilave 50 pike nga pyetjet me përgjigje opsionale, kurse 20 pikë nga eseja), dhe me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses lidhur me vlerësimin e eses apo testimit me shkrim, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e nenit 4 të Rregullore (QRK) NR. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për Procedurën E Pranimit Në Shërbimin Civil ku përcaktohet: *“Obligohet ministria përgjegjëse për administratën publike që brenda një (1) viti nga miratimi i kësaj Rregulloreje, të hartojë një bazë të dhënash me pyetje për testimin me shkrim dhe/apo intervistën me gojë. Deri në krijimin e kësaj baze të dhënash, Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar që jo më herët se njëzet e katër (24) orë para mbajtjes së testit, të hartojë pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara 3/4 në shpalljen për rekrutim. Pyetjet vendosen në sistemin elektronik nga Komisioni, i cili administron procesin e testimit”*, si dhe dispozitat e nenit 9 paragrafi 6 dhe 8 të Rregullores (QRK) 16/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *“6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit”*, dhe konstatoi se sistemi që funksion në kuadër të SIMBNJ-së, është i programuar në atë mënyrë, ashtu që përgjigjen e saktë e ka të identifikueshme dhe vlen njëtrajtshëm për të gjithë kandidatët që i nënshtrohen testimit me shkrim, sikurse edhe në rrethanat e rastit konkret, ndërsa Komisioni i Pranimit e vlerëson vetëm esenë, nga rrjedh

se sipas formularit të datës 03.12.2025 me shifër CN7812-ankuesja për vlerësimin e eses nga anëtarët e komisionit është vlerësuar me gjithsejtë (0) pikë, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 9 paragrafi 9 të së njëjtës rregullore: “9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. **Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim.**” dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se pretendimet e ankueses nuk janë të bazuara, ngase nuk gjeti se në këtë fazë ka pasur shkelje sikurse ankuesja pretendon, për rrjedhojë ankuesja nuk ka arritur ta argumentojë faktin me asnjë provë se për çfarë arsye e njëjta është dashur të vlerësohet me më shumë pikë në testin me shkrim, ngase eseja me shkrim ka qenë “Vlerësimi expost i aktit juridik”, kurse përgjigjja e ankueses ka qenë si në vijim: “*siç po shihet vetëm katër kandidat jemi prezent ne test me shkrim, perse nuk e keni publikuar ne web faqen e komunës vendimin për anulim te konkursit sipas procedurave ligjore? si dhe prezent ne salle qenka edhe kandidatja e cila nuk i plotëson kushtet për këtë pozite siç e ka vërtetuar edhe vete këshilli i pavarur mbikëqyrës me vendimin e tije ne lidhje me kthimin nga pika 0 e konkursit, vlen te theksohet shume por po shihet edhe ky rezultat!*”, ashtu që përgjigja në fjalë nuk korrespondon me esenë në fjalë, respektivisht ankuesja e ka zgjedhur rubrikën e dedikuar për përgjigje të eses që ta shfrytëzojë si hapësirë për paraqitje te pretendimeve ankimore, çështje kjo e cila nuk parashihet me ligjin material, prandaj Komisioni i Pranimit nuk kanë pasur se si të vlerësojnë me pikë përgjigjen në fjalë për esenë përkatëse.

Andaj, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit, vendosi që refuzoi ankesën ankueses pasi që e njëjta nuk ishte e bazuar, ndërsa vendosi të lë në fuqi Njoftimin me numër protokolli 02-016/01, të datës 15.12.2025 për rezultatet përfundimtare pasi që rezulton se akti në fjalë është nxjerrë në procedurë të rekrutimit sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara nga neni 8 paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, sikurse është përcaktuar edhe në dispozitivin e këtij vendimi, prandaj konkursi me Nr. Reference: RN00017761 për pozitën Zyrtar për Zhvillim Socio Ekonomik, ka mbetur në fuqi, ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duhet të veprojë sipas përcaktimeve ligjore nga neni 14 i Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.2071/2025, datë 06/02/2026

Flakron GASHI

Arben MEHMETI

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses G.B;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.